

17 dhjetor 2025,
Prishtinë

Komisioni i Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), në bazë të kompetencave të dhëna me aktet normative të FBK-së, nën suaza të mandatit që ushtron, në mbledhjen e mbajtur me datë 16.12.2025, në përbërje prej: Armend Hamiti kryetar i KG, Arianit Shala anëtar i KG dhe Ismet Ferati anëtar i KG shqyrtoi dhe miratoi këtë:

VENDIM NR.17/ 2025-26 I KOMISIONIT TË GARAVE

- I. Komisioni i Garave ka shqyrtuar kërkesën e paraqitur nga lojtari Altin Morina për marrjen e statusit si lojtar i lirë si lojtar i lirë ("free agent")¹ jashtë afatit kalimtar.
- II. Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë dhe duke u bazuar në nenet përkatëse të Rregullores për Regjistrim dhe Kalim të FBK-së, dhe pasi janë plotësuar kushtet e nevojshme ligjore dhe sportive, Komisioni i Garave VENDOS: MIRATOHET kërkesa e lojtarit Altin Morina për marrjen e statusit "Lojtar i Lirë" ("Free Agent") jashtë afatit kalimtar. Lojtari nga kjo datë ka të drejtë të negociojë dhe të nënshkruajë kontratë me cilindo klub brenda FBK-së apo në kampionate të jashtme, pa kufizime të vendosura nga ekipi i tij i mëparshëm.
- III. Ky vendim hyn në fuqi nga data e publikimit.

¹ **Lojtar i lirë (free agent)** – lojtar të cilit i ka përfunduar kontrata me ekipin e tij të mëparshëm (nuk ka kontratë aktive/valide) dhe është i lirë të nënshkruajë një kontratë të re me cilindo ekip tjetër. Një lojtar i lirë ka të drejtë të negociojë dhe të pranojë oferta nga ekipet e tjera pa kufizime të vendosura nga ekipi i tij i mëparshëm.

ARSYETIM

Gjatë vendimmarrjes lidhur me dispozitivin e Vendimit Nr.17/2025-26, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

- (a) Komisioni i Garave pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe në bazë të Rregullores për Regjistrim dhe Kalim të FBK-së për sezonin 2025/2026, konstaton sa vijon:
- (b) Lojtari Altin Morina deri më tani ka qenë pjesë e KB Bashkimi.
- (c) Lojtari shihet se me marrëveshje ka shkëput kontratën me KB Bashkimi dhe se i njëjti është i lire te negocioj dhe te arrij marrëveshje me klub tjetër.
- (d) Komisioni i Garave vëren se, duke qenë se plotësohen të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregulloren për Regjistrim dhe Kalim të FBK-së për sezonin 2025/2026, Altin Morina **merr** statusin e lojtarit të lirë.

Komisioni i Garave:


Arianit Shala

Anëtar



Armend Hamiti

Kryetar



Ismet Ferati

Anëtar

Federata e Basketbollit të Kosovës

KËSHILLË JURIDIKE: Në pajtim me Nenin 45 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, Edicioni 2025/2026, në vendimin e Komisionit të Garave është e lejuar ankesa tek Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit të FBK-së (si organ i shkallës së dytë), e cila dorëzohet më së voni 24 orë pas marrjes së vendimit. Për ankesë, paraqitësi i ankesës duhet të deponojë në llogarinë e FBK-së shumën prej 500.00 €.